



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 516/2 Prot.

Tiranë, më 23 /06/2015

VENDIM

Nr. 41, datë 23/6 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Shoqëria “Çabej” shpk, përfaqësuar nga Av. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 516 Prot., datë 03.06.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Komunës Zall-Herr, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi nëpërmjet shkresës të datës 21.04.2015, ka kërkuar nga Komuna Zall-Herr t’i vihet në dispozicion informacion me shkrim si dhe të pajiset me kopje të plotë të praktikës administrative për furnizimin me shërbime/produktet “Pemë dekorative për ambiente të jashtme” sipas faturës tatimore nr.8, datë 15.12.2010.

Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Z. , në përputhje me pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me shkresën nr. 516/1 Prot., datë 08.06.2015, ka kërkuar nga Komuna Zall-Herr të paraqesë parashtrime me shkrim brenda datës 16.06.2015, por Autoriteti publik nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

Bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, informacioni i kërkuar konsiderohet publik dhe si tillë duhet vënë në dispozicion të kërkuarit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Shoqërisë “Çabej” shpk, nr.516 Prot., datë 03.06.2015, kundër Autoritetit Publik/ Komuna Zall-Herr, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Komunës Zall-Herr, për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u dha sot në datë 23.06.2015.

